



POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

7

Italia fundos forcat populiste: Qendra e majtë fiton 5 qytetet kryesore

2

'Pa Gjurmë! gjen pas 27 vitesh në Itali Bukurie Dervishi, shpërthen në lot e bija në studion e Report Tv: Nuk e njoha zërin dhe imazhin e saj

3

"C'vaksinim more?! Tensione te Fakulteti i Filologjisë në Tiranë, studentët duan të futen në auditore

4

Pëllumb Kulla rrëfen batutat e Dritëro Agollit me Enver Hoxhën: Shkurt, o shoku Enver, unë me një nga këto, heroinkat tona pozitive, nuk do të martohesha kurrë

5

Skandali në Fiks Fare/ Tampon fals COVID-i për t'u futur në Burgun e Peqinit!

KronikëTirana

Zbulohet laborator i kanabisit në Tiranë, arrestohen 2 trafikantët dhe roja 50-vjeçar

Zbulohet laborator i kanabisit në Tiranë, arrestohen 2 trafikantët dhe roja 50-vjeçar



Arma dhe kanabisi i sekuestruar

[Sh]Redaksia

7 Tetor, 11:15 | Përditësimi i fundit: 7 Tetor, 11:42

A

A

TIRANË- Një laborator droge është zbuluar në Tiranë, ku në pranga kanë rënë 3 persona, mes tyre edhe një grua 54-vjeçare. Report Tv mëson se kjo banesë ishte në zonën e Kombinatit në të cilën punonin një i ri me initiale A. A., 28 vjeç dhe grua 54-vjeçe Xh. I..

Ata kishin përshtatur ambientin e një banese, me aparatura që shërbejnë për tharjen dhe prodhimin e lëndëve narkotike, të cilën e paketonin dhe e bënin gati për shpërndarje me doza për përdorues të ndryshëm. Për këtë ishte punësuar edhe një roje, i cili sinjalizonte 2 të tjerët për çdo lëvizje të dyshimtë, për pasojë sot 50 vjeçarit H. T., iu vunë pranga.

[Sh]LEXO EDHE:

Kompanitë e transportit kërkojnë 4 mln €, letër Bashkisë së Tiranës: Kompesoni biletat dhe abonetë ose vetëm 20% e urbanëve do dalin në qarkullim

Ky operacion i koduar "Aroma" ka zgjatur disa javë dhe si rezultat të tij, përveç arrestimit të 3 personave, u sekuestruan dhe 27 kg lëndë e dyshuar kanabis, një armë zjarri pistoletë, aparatura që shërbejnë për tharjen dhe prodhimin e lëndës narkotike, doza me lëndë të dyshuar kokainë dhe sende të tjera të kundërligjshme.

Ndaj të arrestuarve, rëndojnë akuzat për veprat penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve" e kryer në bashkëpunim dhe "Armëmbajtja pa leje", njofton Policia.

Njoftimi i plotë i Policisë së Shtetit

"Finalizohet një tjetër operacion policor për goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e narkotikëve dhe armëmbajtjes pa leje. Operacioni policor i koduar "Aroma" i zhvilluar nga Seksioni i Narkotikëve dhe Sektori e Krimeve të Rënda, në bashkëpunim me Komisariatin e Policisë Nr.6 dhe Forcën e Posaçme "Shqiponjat".

Kishin përshtatur banesën për kultivimin e bimëve narkotike, vihen në pranga 2 shtetas. Në pranga dhe një shtetas tjetër, i cili ruante ambientin e jashtëm të kësaj banese.

Sekuestrohen 27 kg lëndë e dyshuar kanabis, një armë zjarri pistoletë, aparatura që shërbejnë për tharjen dhe prodhimin e lëndës narkotike, doza me lëndë të dyshuar kokainë dhe sende të tjera të kundërligjshme. Shërbimet e Seksionit për Hetimin e Narkotikëve në DVP Tiranë dhe Sektori për Krimet e Rënda, në bashkëpunim me Komisariatin e Policisë Nr.6 dhe Forcën e Posaçme "Shqiponjat", pas një pune hetimore disajvare, finalizuan operacionin antikanabis të koduar "Aroma", në kuadër të të cilit u arrestuan në flagrancë shtetasit:

A. A., 28 vjeç dhe Xh. I., 54 vjeçe.

Këta shtetas, në bashkëpunim me njëri-tjetrin, kishin përshtatur ambientin e një banese, me aparatura që shërbejnë për tharjen dhe prodhimin e lëndëve narkotike, të cilën e paketonin dhe e bënin gati për shpërndarje me doza për përdorues të ndryshëm. Në vijim të operacionit u bë arrestimi në flagrancë i shtetasit H. T., 50 vjeç, i cili kishte detyrë të ruante ambientin e jashtëm të banesës dhe të raportonte te dy shtetasit e tjerë në rast se shikonte lëvizjeve të dyshimta.

Gjatë kontrollit të banesës u gjetën dhe u sekuestruan në cilësinë e provës materiale 27 kg lëndë e dyshuar kanabis, një armë zjarri pistoletë, municion luftarak, aparatura që shërbejnë për tharjen dhe prodhimin e lëndës narkotike, doza me lëndë të dyshuar kokainë, një peshore elektronike dhe një automjet. Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për veprat penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve" e kryer në bashkëpunim dhe "Armëmbajtja pa leje".

B.K./Shqiptarja.com

TAG: trafik droge Tirane policia e tiranes laborator droge arrestohen

Ndalohet repretësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH

SONDAZHI I DITËS:

A ju duket e drejtë që studentët e pavaksinuar të frekuentojnë auditorët duke rrezikuar shëndetin e të tjerëve?

PO

JO

NUK KAM MENDIM

Komento

Lajme të tjera

Lajme nga emisionet



Lapaj te '5 Pyetjet': 3 arsyet kryesore se përse në protestën e sotme kishte më pak pjesëmarrës, disa janë me partinë, të tjerët kanë valixhet gati për të ikur nga Shqipëria

18 Tetor, 21:59

Politikë



Vrasja e deputetit britanik në një takim elektoral, kampi Ashraf 3 në Tiranë ceremoni përkujtimore: Një mik i dashur për Rezistencën Iraniane

18 Tetor, 21:33

Kronikë



Nga nesër në mbrëmje, ja si do të devijohet trafiku në Unazën e Re, për shkak të punimeve (HARTA)

18 Tetor, 20:27

Sociale



Sherri me karrike mes mësueseve te shkolla 'Çajupi' në Tiranë, ku u përdor edhe arma, jep dorëheqjen drejtoresha

18 Tetor, 18:54

Sociale



Qytetarët mblidhen para kryeministrit, sërish protestë për rritjen e çmimeve: Nuk jemi të varfër, por të vjedhur! Mjaft me propagandë

18 Tetor, 18:49

Kronikë



Qëlluan me armë zjarri dhe terrorizuan banorët, arrestohen dy të rinjtë në Vorë

18 Tetor, 12:05